



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 43 Prot.

Tiranë, më 07/07/2020

VENDIM
Nr. 19, datë 07.07.2020

PËR
“MOSMIRATIMIN E KANDIDATURËS PËR AUTORITETIN DREJTUES “REKTOR”
NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të nenit 36, 39 e vijues të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 28 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të nenit 6, 18, 24, 25 e vijues të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, të Vendimeve të Komisionit Institucional Zgjedhor të UMT-së nr. 7, datë 14.05.2020 “Për shpalljen e hapjes së aplikimeve dhe pranimin e dokumentacionit për kandidatët për Rektor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” dhe nr. 15, datë 30.06.2020 “Për shpalljen e rihapjes së aplikimeve dhe pranimin e dokumentacionit për kandidatët për Rektor në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Komisioni Institucional Zgjedhor i UMT-së, pasi verifikoi dokumentacionin e dorëzuar nga aplikanti Prof. Petrit Ymer Bara, në mbledhjen e datës 07.07.2020,

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e kandidatit për Autoritet Drejtues “Rektor” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, të Z. Petrit Ymer Bara, për mangësi të evidentuara në dokumentacionin e aplikimit.
2. Argumentimi mbi mosmiratimin e kandidaturës për Autoritet Drejtues “Rektor” në UMT, të Z. Petrit Ymer Bara jepet bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, një kopje i tij i dërgohet kandidatit për Rektor z. Petrit Ymer Bara, afishohet në ambientet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

KRYETAR
SILVANA BALA

Anëtarët:

IRENA SEFERI
ALBANA BANUSHI
MIGENA GEGA



NIKO HYKA
ANDIS QENDRO
DEA CENOMERI